



GJYKATA KOMERCIALE – DHOMA E SHKALLËS SË DYTË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Krenar Berisha dhe Saranda Bogaj – Sheremeti, anëtare të kolegjit, në çështjen juridike - konfliktin administrativ sipas propozuesit – paditësit “Adi” sh.p.k me seli ne Prishtinë, te cilin sipas autorizimit e përfaqëson Editon Osmani, kundër kundërshtares se propozimit - të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës me seli ne Prishtinë, me bazë juridike për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, nr.135/2024, datë 08.05.2024, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit -propozuesit kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.315/24, të datës 11.06.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 11.07.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e kundërpropozueses – te paditurës Administrata Tatimore e Kosovës me seli ne Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkalles së Parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.315/24, të datës 11.06.2024, **ANULOHET** dhe lënda i kthehet në rigjykim dhe rivendosje, gjykatës se shkallës së parë.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.315/24, të datës 11.06.2024, është aprovuar propozimi i paditësit “Adi” sh.p.k me seli ne Prishtinë, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit nr.135/2024, datë 08.05.2024, të Administratës Tatimore te Kosovës me seli ne Prishtinë, më të cilin vendim ne piken I te dispozitivit është refuzuar si e bazuar ankesa 135/2024 e dt.29.04.2024, e subjektit “Adi” sh.p.k me seli ne Prishtinë, kurse ne piken II është konstatuar se, njoftim vlerësimet mbesin obliguese sipas rezultateve te kontrollit

Kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti Fiskal, ka ushtruar ankesë i autorizuari i te paditurës – kunderpropozueses Administrata Tatimore e Kosovës me seli ne Prishtinë, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkalles se dyte aktvendimin e kontestuar ta ndryshon dhe të aprovojë kërkesën e te paditurës – kunderpopozueses për lejimin e masës së propozuar apo ta prish aktvendimin e goditur dhe lëndën ta kthejë gjykatës së shkallës së parë për rivendosje.

Kolegji i Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, dhe pas vlerësimit të aktvendimit të kundërshtuar në pajtim me nenin 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për konfliktin administrativ (LKA), ka gjetur se:

Ankesa është e bazuar.

Duke shqyrtuar shkresat e lëndës, aktvendimin e kundërshtuar sipas ankesës së kunderpropozuesit-te paditurës, kolegji i kësaj gjykate, gjen se gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të propozimit të paditësit për shtyrje e ekzekutimit të vendim nr.135/2024, datë 08.05.2024, të Administratës Tatimore te Kosovës me seli ne Prishtinë, ka gjetur se propozimi i tillë është i bazuar, ngase paditësi e ka bërë të besueshme dhe përmes provave te prezantuara ka arritur te vërtetoj faktin se ekzekutimi i vendimit do te i sillte dëme paditësit, i cili vështirë se do te riparohej, duke ju referuar dispozitave ligjore të nenit 22 par.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA).

Kolegji i Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, nuk e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm një konkludim të tillë të gjykatës së shkallës së parë ngase edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 par. 6 lidhur me par. 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, i cili përcakton se: “me kërkesë te paditësit, organi akt i te cilit ekzekutohet gjegjësisht organi qe është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri ne vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do ti sillte dem paditësit, i cili vështir do te riparohej, kurse shtyrja nuk është ne kundërshtim me interesin publik, as qe shtyrja do ti sjellte ndonjë dem te madhe palës kundërshtare përkatësisht personit te interesuar”. Po ashtu për gjykatën e shkalles se dyte është i papranueshëm qëndrimin i gjykatës se shkalles se pare, se e paditura për çdo dite vonese ne pagesën e detyrimeve tatimore nga ana e palës paditëse te njëjtin e ngarkon me pagesën e ndëshkimit dhe interesit te parapare ne nenin 51, te Ligjit nr.03/L-222, andaj shtyrja nuk do ti sjellte ndonjë dëme palës kundërshtare

Gjykata e Shkalles se pare me rastin e vendosjes sipas propozimit te paditësit, pa te drejte ka gjetur se shtyrja e ekzekutimit te vendimit deri ne vendosjen e çështjes ne mënyre meritore, nuk është ne kundërshtim me interesin publik e as qe do t'i sillte ndonjë dëme palës kundërshtare apo personave te interesuar, me sakte një vendim i tille do ti shmange pasojat e mundshme qe do ti shkaktoheshin ne te ardhmen. Gjykata e shkalles se pare ne arsyetim te vendimit te atakuar nuk e ka arsyetuar faktin dhe njëkohësisht kushtin ligjore (se shtyrja e ekzekutimit te vendimit, pra caktimi i masës se përkohshme nuk është ne kundërshtim me interesin publik) mirëpo vetëm e ka bere një përshkrim te tille duke mos e arsyetuar, po ashtu gjykata e shkalles se parë, me asnjë prove te vetme nuk e ka arsyetuar faktin se pa shtyrje e ekzekutimit te vendimit, paditësi – propozuesi do te mund te pësonte dëme te pa riparueshëm, ne rast te mbledhjes se detyrueshëm te borxhit tatimor nga ana e te paditurës.

Ne aktvendimin e atakuar, nuk është arsyetuar as fakti se mbledhja e borgjit nga e paditura do te shpiente ne veshtriasi falimentimi palën paditëse, e ne veçanti duke qene se

nga shkresat e lendes nuk rezulton një fakt i tille, për arsye se siç rezulton nga kundërshtimet e te paditurës – kundërshtares se sigurimit, këtu pala paditëse – propozuese e sigurimit gjate viteve kontestuese ka pasur qarkullim ekonomik me miliona euro.

Andaj, rezulton se, gjykata e shkalles se pare ne vendimin e saj, gabimisht ka konstatuar se paditësja ne pretendimet e saja mjaftueshëm ka arsyetuar se te njëjtat janë te bazuara ne Ligj dhe se ne rastin konkret janë përmbushur kushtet Ligjore qe te aprovohet propozimi për shtyerje te ekzekutimit te vendimit deri sa gjykata te vendos përfundimisht lidhur me ligjshmërinë e vendimit te kontestuar përkitazi me padinë e paditësit e ne kuptim te nenit 22 te LKA-se.

Duke i marrë parasysh pretendimet ankimore të kunderpropozueses- te paditurës, në ankesë të cekura më lartë ndaj aktvendimit të shkallës së parë, kolegji vlerëson se të njëjtat janë të vërtetuara, të mjaftueshme dhe bindëse për tu aprovuar ankesa.

Derisa pretendimet ne padi dhe përgjigje ne ankese te palës paditëse, me te cilat është kërkuar caktimi i masës së përkohshme për shtyrjen të ekzekutimit të aktit administrativ, të atakuar deri në vendosjen sipas padisë së paditësit janë të pabazuara dhe se vlerësimi i kolegjit është se janë përmbushur kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit siç parashihet në nenin 6 dhe 22 par.2 të LKA-së.

Mbi këtë gjendje të fakteve kolegji gjen se Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti Fiskal në mënyrë jo të drejt ka vërtetuar gjendjen faktike dhe jo drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, kur ka konstatuar se është cenuar ligji në dëm të ankuesit me rastin e caktimit te masës se përkohshme dhe shtyrjes se ekzekutimit te vendimit dhe se pretendimet ankimore janë me ndikim për vendosje në mënyrë tjetër, andaj ankesa si e tillë aprovohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar priset dhe lënda kthehet ne rivendosje, ku gjykata e shkalles se pare ka për obligim te arsyetoj faktet ne te cilat mbështet arsyetimin e vendimit, e ne veçanti faktin se pa caktimin e masës do te vështirësohej gjendja financiare e propozuesit qe eventualisht do te e shpiente drejt falimentimit.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën d) të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVES
Dhoma e Shkallës së Dytë
Kom.Dh.Shk.II.nr.1312/2024, me datë 11.07.2024

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari
Faton Bajrami, d.v